AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Nr. 2130 Prot.
Datë, më 19.06.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK NR.4

Nr.394/2 prot

Tiranë me 15.06.2023

Lënda: Njoftim per vend të lire pune

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional",
DROFPP Nr.4, ju njofton krijimin e vendit të lire të punës, për pozicionin :

1. **Instruktor/e me kohë të pjesshme Llamarinist Bojatisje (DROFPP Nr. 4 Tiranë) -- - 1 person**
2. **Instruktor/e me kohë të pjesshme Graphic Design (DROFPP Nr. 4 Tiranë) --- 1 person**

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme
Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:
a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesmës në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit
Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;
b) jetëshkrimin (CV-në);
c) kartën e identitetit;
d) diplomën;
e) librezën e punës;
f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g) certifikatën dhe dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin DROFPP NR.4 Tirane, brenda datës 04.07.2023

Duke ju falenderuar per mirekuptimin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT DHE AFTËSIVE